



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi \_ dhe neni 23 të Ligjit për parandalim të Korrupsionit dhe konfliktit të interesave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë „, numer 12 / 2019 ) nenit 40 dhe 41 të Rregullores për punë të Komisionit shtetërorë për parandalimin e korrupsionit, duke vepruar sipas një denoncimi të parashtruar prej denoncuesit ..... në vazhdimin e seancës së 42-të e mbajtur me datë 14 dhjetorë të vitit 2020 Komisioni Shtetëror për parandalimin e korrupsionit miratoi në vijim

## VENDIM

**NDËRPRITET** procedura për lëndën me nr. 12-4290/1 të datës 29.08.2019 formuar në bazë të dënoncimit nga parashtruesi ..... para Komisionit Shtetëror kundër korrupsionit (KSHPK).

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndë me nr. 12-4290/1 nga data 29.08.2019 për arsye se akuzat e parashtruara në denoncim bashkë me dokumentacionin është vërtetuar se për procedurën e përmendur për punësim, ishte vepruar në përputhje me nenin 160 dhe 161 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.

KSHPK vërtetonë se në rastin konkret Drejtori e ka përdorur të drejtën diskrete në bazë të nenit 161 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore, për zgjedhjen e kandidatit nga rang lista e bashkangjitur sipas zgjedhjes së tij dhe jo në bazë të pikave të cilat kandidati i ka përvetësuar në të gjitha fazat e procedurës së zgjedhjes, gjë që paraqet rrezik për keqpërdorim të mundëshëm të autorizimit diskret gjatë procedurave të punësimit të personave të rinjë nga ana e personave udhëheqës të institucioneve.

Lënda të mbyllet dhe të arkivohet

Deri tek parashtruesi i dënoncimit të dërgohet vendimi me arsyetim.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditësh.

## Sqarim

Lënda me numër 12-4055/1 e datës 29.08.2019 denoncim i formuar me kërkes të parashtruesit ..... dërguar deri tek KSHPK.

Në denoncimi e parashtruar egëzistojnë dyshime për kryerje e veprimit joligjorë ne procedurën e e punësimit të 6 (gjashtë) motrave medicinale në bazë të skonskursit të shpallur zyrtarë më 12.06.2019. Parashtruesi i dënoncimit i punësuar në këtë institucion pothuaj së 16 vjetë në rerpartin e paliaativës si personel ndihmës, ka aplikuar në konkursin e shpallur publik, e ka kryer provimin dhe më vonë është njoftuar se nukë është

e pranuar, për shkak të provimit të dobët . Në denoncim shpreh paknaqësinë për pranimin e të drejtës diskrecionale të drejtorit që të vendosë se a do të shpallet konkursë interes apo publikë, si dhe të kryej zgjedhjen e kandidatëve, të cilët vijnë prej jashtë në kushte kur ka persona të punësuar të cilët kanë arritur përvojë pune në institucion.

Denoncuesja thirret në Marveshjen Kolektive për shëndetësi dhe kërkon që të shqyrtohet rasti nga KSHPK repektivisht realizimin e të drejtës diskrecionale të Drejtorit të SHSHP në spitalin e Specializuar për për gerijatri dhe medicinë paliajative ..... me të cilën kërkohet që të dërgohet informacioni i plotë për rrjedhën e procedurës së punësimit me dokumentacione të bashkangjitura – Procesverbal nga realizimi i testit profesional nga kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet për atë fazë në datën 17.07.2019 , porcesverbali me intervistën e kryer me kandidatët dhe Vendimi për zgjedhjen e kandidatëve.

Në afatatin e përcaktuar ligjorë ishte dërguar përgjigje nga SHSHP Spital i specializuar për mjekësi gerijatri dhe plijstivë ..... Nga analizat e kryera në dokumentacionin e mbledhur , KSHPK për gjedhjen faktike vërteton si në vijim :

Konkursi i shpallur publikë për punësimin e 6(gjashtë) motra medicinale ishte in publikuar në gazetar ditore Nova Makedonija dhe Koha në datën 12.06.2019 dhe procedura sipas shpalljes ishte realizuar pa asnjë lëshim në të gjitha fazat në përputhëshmëri me Ligjin për mbrojtje shëndetësore. Më datën 05.07.2019 deri tek UD Drjtorë në SHHPnë e lartëpërmendur, është dërguar raport nga puna e Komisionit për seleksionim të kandidatëve të protokoluar më nr. 04-1582/2 nga data 05.07.2019 me listën e kandidatëve të cilët kanë aplikuar në Konkursin e shpallur publik dhe me listën e kandidatëve të cilat i plotësojnë kushtet për fazën e ardhëshme repektivisht provimit profesional. Deri tek Ministria e Shëndetësisë ishte derguar njoftim me nr. 04-1583/3 në datën 05.07.2019 me listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për fazën e ardhëshme , për provimi profesional, dhe si mundë të organizohen nga ana e MSH dhe në termin e paraparë me marrëveshje tiu dërgohen testet për provimin profesional.

Më datën 29.05.2019 ishte realizuar intervishta me kandidatët të cilëst i plotësojnë kushtet për këtë fazë nga procedur prej të cilës ishte përpunuar një procesverbal me nr.04-1582/5 nga data 29-07.2019. Në përputhëshmëri me intervistën dhe provimin deri tek USH Drejtorë , i cili me datën 28.07.2019 ka sjellur Vendim për zgjedhjen e kandidatëve me nr. 04-1582/7. Vendimi është i sjellur në pajtueshmëri kriteriumet repektivisht notën mesatare të shkollës së mesme, reyultatet e provimit profesional si dhe në pajtueshmëri me të drejten diskrecionale të Drejtorit duke qen edhe person i cili i ka realiyuar intervistat me kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet për këtë fazë. Në konkursin e shpallur kanë aplikuar 12 kandidatë ndërsa në listën përfundimtare janë të paraqitur 9 më të suksesshëm me numrin e pikëve të fituara nga të gjitha fazat e

seleksionimit, i pri me 78.12 pikë të fituara dhe i fundit me 24. 67 pikë të fituara. Në listën e dërguar denoncuesja është e ranguar në vendin e gjashtë me 30.83 pikë të fituara.

Nga inspektimi i vendimit të sjellur nga Drejtori shihet se janë të zgjedhur 5 së kandidatët e parë nga range lista dhe kandidati i fundit me 24.67 pikë të fituara.

Vendimi për zgjedhje nga ana e Drejtorit të SHSHP Spitalit të specializuar për medicinë garijatriska dhe palijativë ..... ishte i sjellur më datën 20.08.2019 dhe është dërguar te të gjithë kandidatët e paraqitur në konkurs. Në ligjin për mbrojtje shëndetësore neni 161 qëndron kështu:

#### **Neni 161**

(1) Organi udheheqës i institucionit shendetesor, në baze të ranglistes së propozuar nga komisioni për seleksionim me së paku tre kandidate, nese ka më shume se tre kandidate që i plotesojne kushtet, miraton vendim për zgjedhje të kandidatit. (2) Kunder vendimit për zgjedhje nga paragrafi (1) i ketij neni, kandidati i pakenaqur ka të drejte ankesë në afat prej tete ditesh nga dita e pranimit të vendimit permes institucionit shendetesor për nevojat e të cilit eshte shpallur konkursi publik, te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte. (3) Organi nga paragrafi (2) i ketij neni vendos për ankesen në afat prej 15 ditesh nga dita e pranimit të ankeses. (4) Ankesa e prolongon zbatimin e vendimit. (5) Kunder vendimit të miratuar nga Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte, kandidati i pakenaqur ka të drejte padie në gjykaten kompetente. (6) Pas mbarimit të procedures për zgjedhje, organi udheheqës i institucionit shendetesor dhe kandidati i zgjedhur lidhin marreveshje për punesim të punetorit shendetesor perkatesisht bashkepunetorit shendetesor.

Në kohën e paraparë ligjore kundër vendimit për zgjedhje, denoncuesja ka paraqitur ankesë deri tek Komisioni shetërorë për vendosje për procedurën administrative dhe procedurën e punësimit të shkallës së dytë e cila me datën 12.06.2019 ka sjellur Vendim me të cilin ankesa është refuzuar si ankesë e pabazuar me sqarim se organi udhëheqës i institucionit shëndetësor ka të drejtë dikrecionale të bëjë zgjedhje për cilindo kandidatë të propozuar nga ranglista nga ana e Komisionit e formuar për realizimin e konkursit.

Nga procedura e kryer për vërtetimin e gjendjes faktike në rastin konkret, Komisioni Shtetërorë për parandalimin e korrupsionit konstatonë se gjatë realizimit të procedurave të Konkursit të shpallur publikë me datën 12.06.2019 për punësimin e 6(gjastë ) motrave medicinale në SHSHP Spitalit të specializuar për medicinë garijatriska dhe palijativë ..... ishte verpuar në pajtueshmëri me nenin 160 të pajtueshmëri të ligjit për mbrojtje shëndetësore respektivisht ishte formuar Komision për seleksionimin e puntorëve shëndetësor , e cila e ka kryer seleksionimin e kandidatëve në bazë të kriteriumeve të vërtetuara me Ligjë për punësim. Drejtori i SHSHP Spitalit të specializuar për medicinë garijatriska dhe palijativë ..... pas realizimit të intervistës me të gjithë kandidatët e propozuar nga ranglista ka kryer zgjedhjen e kandidatëve dhe ka sjellë Vendim për zgjedhjen e kandidatëve në datën 20.08.2019, me cka ka verpuar në pajtueshmëri me nenin 161 paragrafi 1 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.

Nga inspektimi i ranglistës së propozuar nga ana e Komisionit Shtetërorë për parandalimin e korrupsionit konstatonë se Drejtori i SHSHP Spitalit të specializuar për medicinë garijatriska dhe palijativë ..... e ka shfrytëzuar të drejtën dikretive nga neni 161 të Ligjit për mbrojtje shndetësore të kryej zgjedhje të cilit do kandidatë nga ranglista e propoyuar që i plotëson kushtet e parapara në konkursin e shpallur në bazë

të zgjedhjes së tij personale dhe jo në bazë të pikëve të përgjithëshme që kandidati i ka arritur në të gjitha fazat në procedurën e seleksionimit.

Njëjtë sikur në lëndët tjera në të cilat ka vepruar KSHPK, dhe në rastin konkret KSHPK konstaton se neni 161 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore i mundëson personit udhëheqes të institucionin mjekësor të kryej zgjedhje nga kandidatët e propozuar nga ranlista sipas zgjedhjes së tij personale, dhe jo në bazë të pikëve të përgjithëshme që kandidati i ka arritur në të gjitha fazat në procedurën e seleksionimit. Kjo paraqet rrezik për keqpërdorim të mundëshëm të autorizimit diskrecional gjatë procedurave të punësimit të personave nëpërmjet ndikimeve të ndryshme: nepotizëm, knonizëm, klientarizëm.

Nga kjo Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit vendose në bazë të dispozitave të këtij vendimi.

Me përfundim të senacës KSHPK,  
Punoi: m-r I.P  
Miratoi: S.P.D. antar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËRORE PËR  
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT  
Kyetar: Biljana Ivanovska